



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 maj 2022
Nr.ref.:RK 1994/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI227/21

Parashtrues

Besim dhe Bujar Ajeti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 585/2020, të 14 tetorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Besim dhe Bujar Ajeti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës) të cilët me autorizim përfaqësohen nga Shefqet Hasimi, avokat në Prishtinë

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Rev. nr. 585/2020] të 14 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës iu është shkelur e drejta e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 dhjetor 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 15 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 16 dhjetor 2021, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 5 janar 2022, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve të kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
9. Më 20 janar 2022, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve të kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim të parashtruesve të kërkesës në Gjykatë.
10. Më 21 mars 2022, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtrësë me dokumente, që u referohen procesverbaleve të seancës gjyqësore, të zhvilluar në Gjykatën Themelore, të 31 korrikut 2013 dhe 18 shtatorit 2013, respektivisht dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore për caktimin e masës së sigurisë, të 26 dhjetorit 2013.
11. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezultojnë që parashtruesit e kërkesës janë pasardhësit ligjorë, gjegjësisht të bijtë e S.A. (në tekstin e mëtejme: S.A., i ati i parashtruesve të kërkesës) i cili në një datë të paspecifikuar kishte ndërruar jetë. Nga shkresat e lëndës rezultojnë që në vitin 1971 në mes të R.G dhe J.A, vëllait të S.A (në tekstin e mëtejme: J.A, xhaxhai i parashtruesve të kërkesës) ishte lidhur kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në vitin 1972. Parashtruesit e kërkesës si në dëshminë e tyre para Gjykatës Themelore ashtu edhe në kërkesë e tyre në Gjykatë pohojnë se në kontratë *“figuron emri i [J.A.] që është vëllau i [S.A] sepse në atë kohë për shkak të shtesave femiore që janë marrë në atë kohë babai [i parashtruesve të kërkesës] si blerës fiktiv e bene vëllaun e tij [J.A] që të mos humb këto shtesa.”*
13. Më 9 shkurt 2004 përmes Aktvendimit mbi Trashëgiminë [T. Nr. 15/2004] i ndjeri S.A., i ati i parashtruesve të kërkesës kishte lënë paluajtshmëritë, përkatësisht ngastrat kadastrale me nr. 741/15, nr. 741/16, 1/3 e ngastrës kadastrale me nr. 741/1, të regjistruara në Zonën Kadastrale në Komunën e Prishtinës. Bazuar në këtë Aktvendim, trashëgimtar i paluajtshmërisë së lartcekur ishte shpallur parashtruesi Bujar Ajeti, për faktin se trashëgimtarët e tjerë, përfshirë edhe parashtruesin e kërkesës Besim Ajeti, kishin hequr dorë nga trashëgimia e të atit të tyre.
14. Njëra ngastër kadastrale, nr. 741/14, në sipërfaqe prej 0.13,89 hektarë për të cilën parashtruesit e kërkesës pretendonin se prona e tyre, respektivisht prona e babait të tyre në regjistrin kadastral evidentohet si pronë shoqërore dhe ndaj saj nuk ishte zhvilluar procedura e trashëgimisë.

Procedura kontestimore përkitazi me lëndën [C.nr. 85/08] me palë paditëse J.A.
15. Më 2 korrik 2004, J.A, xhaxhai i parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë parashtroi kërkesëpadi përmes të cilës kërkoi që Komuna e Prishtinës (në cilësinë e të paditurës) t’ia njohë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë, përkatësisht ngastrën kadastrale të evidentuar me nr. 741/14 (në tekstin e mëtejme: paluajtshmëria e kontestuar).
16. Më 6 janar 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C.nr. 1591/2004] aprovoi kërkesëpadinë e J.A dhe vërtetoi se ky i fundit është pronar i paluajtshmërisë, përkatësisht ngastrës kadastrale me nr. 741/14.
17. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, Komuna e Prishtinës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut.
18. Më 10 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 691/05] prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 2 korrikut 2004 dhe lëndën e ktheu në rigjykim në këtë gjykatë.
19. Gjykata e Qarkut konsideroi se: *“[...] përfundim i [Gjykatës Komunale] tani për tani nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Në lëndë nuk ekzistojnë provat në origjinal, por në fotokopje të pavërtetuara dhe jo bindëse, kështu që*

të njëjta nuk paraqesin provë të sigurtë që mbështetet vendimi gjyqësor. [Gjykata Komunale] kanë qenë dashtë të kërkoj nga palët ndërgjyqësore që mundësisht të prezantojnë provat autentike ose në fotokopje të vërtetuara në afat të caktuar gjyqësor, nën kërcënim lëshimi.”

20. Më 12 prill 2013, J.A kishte parashtruar kërkesë për caktimin e masës së sigurisë ndaj paluajtshmërisë së kontestuar.
21. Më 26 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore nxori Aktvendimin [C.nr. 85/08] përmes të cilit, caktoi masën e sigurisë ndaj paluajtshmërisë së kontestuar.

Procedura kontestimore përkitazi me lëndën [C.nr. 85/08] me parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e palës paditëse

22. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në Gjykatë, Gjykata vëren se në procedurë kontestimore me numër të njëjtë të lëndës nga viti 2014, në cilësinë e palëve paditëse figurojnë parashtruesit e kërkesës. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata nuk posedon informacionin specifik se si parashtruesit e kërkesës janë cilësuar apo konsideruar si palë paditëse nga Gjykata Themelore, e cila procedurën kontestimore nga viti 2014 e tutje e ka shqyrtuar me numrin e njëjtë rendor, përkatësisht lëndën me numër [C.nr. 85/08].
23. Bazuar në si më sipër, përkatësisht bazuar në përmbajtjen e aktgjykimeve të kontestuar nga ata rezulton se parashtruesit e kërkesës në cilësinë e palës paditëse kishin kërkuar që ngastra e njëjtë kadastrale me nr. 741/14, e regjistruar si pronë shoqërore të bartet dhe të regjistrohet në emër të tyre. Në kërkesëpadi, parashtruesit e kërkesës pohuan se paluajtshmërinë kontestuese, në vitin 1972 ishte blerë nga i ati i tyre S.A.
24. Më 3 maj 2016, Gjykata Themelore, pas mbajtjes së seancave dëgjimore dhe administrimit të provave, përmes Aktgjykimit [C. Nr. 85/08] kërkesëpadinë e parashtrësve të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
25. Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar prova për ti mbështetur pretendimet e tyre dhe rrjedhimisht konkludoi se asnjë nga bazat për vërtetimin e pronësisë të parapara me ligjet në fuqi nuk ishin plotësuar.
26. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit [C. Nr. 85/08] të Gjykatës Themelore, të 3 majit 2016, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
27. Më 6 korrik 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ca. nr. 3473/2016] refuzoi ankesën e parashtrësve të kërkesës si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. Nr. 85/2008] të 3 majit 2016 të Gjykatës Themelore.
28. Gjykata e Apelit, ndër tjerash vërtetoi qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore si të drejtë dhe të ligjshëm dhe po ashtu konstatoi se parashtruesit e kërkesës

"[...] nuk arritën të provojnë se në patundshmërinë objekt i këtij kontesti e kanë fituar të drejtën e pronësisë. Pretendimet ankimore [parashtruesve të kërkesës] ishin të pathemelta sepse ata nuk dëshmuuan se në patundshmërinë objekt i këtij kontesti e kanë fituar të drejtën e pronësisë, ne ndonjë bazë juridike të përcaktuar me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridik Pronësore, ("Gazeta Zyrtare e ish RSFJS" nr.6/80)."

29. Në vijim, Gjykata e Apelit theksoi se: *"Pretendimet ankimore të paditësve se patundshmëria objekt i këtij kontesti gabimisht është shënuar në emër të paditurës, nuk qëndrojnë, sepse [parashtruesit e kërkesës] kanë pasur mundësi ligjore që këtë çështje ta iniciojnë në procedurë administrative, nën kushtet e parapara me ligj që të kërkojnë evitimin e gabimit eventual të Organit kompetent administrativ, për regjistrimin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore, duke prezantuar dokumentacionin e vlefshëm shkresor si dëshmi se patundshmëria përkatëse ishte prone e tyre."*
30. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
31. Më 14 tetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 585/2020] refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.
32. Gjykata Supreme vërtetoi konstatimin e Gjykatës Themelore, e cila kishte konkluduar se paluajtshmëria asnjëherë nuk kishte qenë e regjistruar në emër të parashtruesve të kërkesës dhe se nuk ishte dëshmuar që ishte në kuadër të paluajtshmërisë së blerë përmes kontratës së 10 janarit 1972, e lidhur ndërmjet J.A dhe R.G.
33. Sipas Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe se aktgjykimi i kësaj të fundit nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore.
34. Gjykata në vijim, i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e parashtruesve të kërkesës se prona e regjistruar është regjistruar në emër të Komunës së Prishtinës përmes një gabimi teknik. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme theksoi se në rast të një gabimi teknik, parashtruesit të kërkesës kanë pasur mundësi që përmes një procedurë administrative të iniciojnë procedurë për korrigjimin e një gabimi të tillë.
35. Gjykata Supreme aprovoi *"vlerësimin e gjykatës së instancës më të ulët, duke marrë për bazë faktin se prona ka qenë e regjistruar si shoqërore dhe nuk është gjetur në emër të paditësve e as që është e vërtetuar se si e kanë fituar pronësinë e pretenduar."*
36. Përfundimisht, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesit e kërkesës me asnjë provë të vlefshme juridike nuk e *"vërtetuan faktin vendimtarë që të njëjtit kanë kryer veprime juridike të vlefshme për të fituar të drejtën e pronës në paluajshmeritë kontestuese, por përkundrazi mbi bazën e fakteve të vërtetuara"*

me provat e administruara është vërtetuar se palujtshmëria lëndore është e evidentuar në prone shoqërore.”

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtën e tyre të garantuar me nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës.
38. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e kërkesës i referohen vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga ana e Gjykatës Themelore, dhe në lidhje me këtë pretendojnë se “[...] këtu kemi të bëjmë me një uzurpim klasik të pronës private duke e shendrruar në prone publike, me gabim teknik të organit të kadastrit i cili ka gabuar gjatë regjistrimit të rrugës kontestuese, në librat e pronësisë. Paraardhësit të [parashtruesve të kërkesës] i është marrë kjo rrugë në mënyrë të padrejtë, duke egzistuar dokumentacioni, dhe pa asnjë mënyrë a formë klasike se si mirret një paluajtshmëri nga personat privat(fizik), siç janë procedurat e eksproprijimit a nacionalizimit, nga ana e shtetit.”
39. Parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pretendojnë se: “organet e instancave me të ULTA kanë bërë shkelje drastike të këtij neni, për të cilat nuk kanë asnjë dëshmi se në çfarë baze prona ka kaluar nga prona private në pronë Shoqërore.”
40. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që kërkesën e tyre ta shpallë si të pranueshme.

Dispozitat relevante kushtetuese

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 46 [Mbrotja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
42. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

43. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 [Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

44. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë: palë e autorizuar; kontestojnë Aktgjykimin [Rev. nr. 585/2020] të 14 tetorit 2021e Gjykatës Supreme; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se i janë shkelur; kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

45. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi 2 i rregulli 39 të Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

46. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtgues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtgues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; KI21/21, me parashtgues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, KI107/21, me parashtgues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
47. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtguesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
48. Gjykata fillimisht rikujton se përfaqësuesi ligjor i parashtguesve të kërkesës, më 21 mars 2022 dorëzoi në Gjykatë një parashtresë me dokumente, që i referohen procesverbaleve të seancës gjyqësore, të zhvilluar në Gjykatën Themelore, më 31 korrik 2013 dhe 18 shtator 2013, respektivisht dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore për caktimin e masës së sigurisë, të 26 dhjetorit 2013. Ky dokumentacion i bashkëngjitur i referohet procedurës kontestimore [C. Nr. 85/2008] me palë paditëse J.A., xhaxhai i parashtguesve të kërkesës. Kjo parashtresë e dorëzuar më 21 mars 2022 e përcjellë me dokumente shtesë i referohet procedurës kontestimore të zhvilluar në vitin 2013 në Gjykatën

Themelore, në të cilën procedurë me numër të njëjtë të lëndës [C. Nr. 85/2008] parashtruesit e kërkesës nuk ishin palë ndërgjygjëse por në cilësinë e paditësit ishte J.A, xhaxhai i parashtruesve të kërkesës.

49. Rrjedhimisht, Gjykata vë në pah, se objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës janë aktgjykimet e gjykatave të rregullta, në procedurat e të cilave parashtruesit e kërkesës janë palë paditëse, ankese dhe parashtrues të kërkesës për revizion respektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata ripërsërit se objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës janë: Aktgjykimi [C. Nr. 85/08], i 3 majit 2016, i Gjykatës Themelore; Aktgjykimi [Ca. Nr. 3473/2016, i 6 korrikut 2020, i Gjykatës së Apelit; dhe Aktgjykimi [Rev. Nr. 585/2020] i 14 tetorit 2021, i Gjykatës Supreme.
50. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës përmes të cilës kishin theksuar që paluajtshmëria e kontestuar e blerë nga i ati i tyre S.A në vitin 1971, në regjistrat kadastralë ishte regjistruar gabimisht si pronë shoqërore. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës në kërkesëpadinë e tyre kërkuan që kjo paluajtshmëri të bartet dhe të regjistrohet në emër të tyre si pronë private. Gjykata Themelore, pas mbajtjes së seancave dëgjimore dhe administrimit të provave kishte refuzuar kërkesëpadinë e tyre duke konstatuar se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar prova për ti mbështetur pretendimet e tyre dhe rrjedhimisht kishte konkluduar se asnjë nga bazat për vërtetimin e pronësisë të parapara me ligjet në fuqi nuk ishin plotësuar. Si rezultat i ankesës së tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit ankesën e tyre e kishte refuzuar si të pabazuar duke e vërtetuar konstatimin e dhënë përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Këtë konstatim të Gjykatës së Apelit, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme, e cila përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 585/2020] të 14 tetorit 2021 kishte refuzuar revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës se prona e regjistruar është regjistruar në emër të Komunës së Prishtinës përmes një gabimi teknik i refuzoi si të pabazuara duke vlerësuar se në rast të një gabimi teknik, parashtruesit të kërkesës kanë pasur mundësi që përmes një procedurë administrative të iniciojnë procedurë për korrigjimin e një gabimi i tillë.
51. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës.
52. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pretendojnë se atyre i është shkelur e drejta në pronë, dhe në lidhje me këtë, në thelb specifikojnë se ata janë pronarë të paluajtshmërisë, e cila gabimisht në regjistrat kadastralë është regjistruar si pronë shoqërore e Komunës së Prishtinës.
53. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës që ndërlidhet me konstatimin e gjykatave të rregullta se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar prova për ti mbështetur pretendimet e tyre dhe rrjedhimisht kishte konkluduar asnjë nga bazat për vërtetimin e pronësisë të parapara me ligjet në fuqi nuk ishin plotësuar bie në kategorinë e pretendimeve “të shkallës

së katërt”, sepse ngërthen çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “ligjshmërisë” dhe jo “kushtetutshmërisë”.

54. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, parashtues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 61).
55. Në këtë drejtim, dhe në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata nuk mund, si rregull i përgjithshëm, të vë në dyshim gjetjet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI163/18, me parashtues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 73).
56. Për sa i përket këtij pretendimit të parashtuesve të kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta, gjegjësisht atyre të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ofruan arsyetimin përkatës për refuzimin e kërkesëpadisë, ankesës dhe revizionit, respektivisht. Të tri instancat e gjykatave të rregullta vërtetuan se parashtuesit e kërkesës nuk kanë ofruar prova për ti mbështetur pretendimet e tyre duke konkluduar se asnjë nga bazat për vërtetimin e pronësisë të parapara me ligjet në fuqi nuk ishin plotësuar.
57. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht rikujton konstatimin e Gjykatës Themelore, e cila ndër tjerash kishte theksuar se: “Gjykata e pranoi në tersi si të bazuar ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë i cili në bazë të gjendjes faktike, matjeve në terren si dhe dokumentacionin i cili evidentohet në regjistrin kadastral në mënyrë profesionale dhe mjaft të argumentuar ka dhënë mendimin e tii me shkrim si dhe ka dhënë sqarime/shtesë në seancën e shqyrtimit kryesor sipas kërkesës së [parashtuesve të kërkesës]. Andaj gjykata erdhi në përfundim se për këtë çështje juridike kontestimore përkundër pretendimeve të paditesve se kjo palujtshmëri është pjese e ngastrës kadastrale sipas kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nr.3272/72 date 10.01.1972 dhe se kjo rrugë gabimisht është evidentuar si rrugë publike, pretendimet e tilla nuk janë argumentuar me asnjë provë.”
58. Në vazhdim, Gjykata po ashtu i referohet Aktgjykimit [Ca. nr. 3473/2016] të 6 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit, përmes të cilës kjo e fundit, ndër tjerash kishte theksuar se: “Pretendimet ankimore të paditësve se patundshmëria

objekt i këtij kontesti gabimisht është shënuar në emër të paditurës, nuk qëndrojnë, sepse [parashtruesit e kërkesës] kanë pasur mundësi ligjore që këtë çështje ta iniciojnë në procedurë administrative, nën kushtet e parapara me ligj që të kërkojnë evitimin e gabimit eventual të Organit kompetent administrativ, për regjistrimin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore, duke prezantuar dokumentacionin e vlefshëm shkresor si dëshmi se patundshmëria përkatëse ishte prone e tyre.”

59. Më tutje, Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Supreme në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës të ngritura në revizionin e tyre të parashtruar në këtë gjykatë, në esencë kishte: (i) konstatuar se Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale; (ii) i refuzoi si të pabazuara pretendimet e parashtruesve të kërkesës se prona e regjistruar është regjistruar në emër të Komunës së Prishtinës përmes një gabimi teknik. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme theksoi se në rast të një gabimi teknik, parashtruesit të kërkesës kanë pasur mundësi që përmes një procedurë administrative të iniciojnë procedurë për korrigjimin e një gabimi i tillë.; dhe (iii) konkludoi se parashtruesit e kërkesës me asnjë provë të vlefshme juridike nuk e “vërtetuan faktin vendimtarë që të njëjtit kanë kryer veprime juridike të vlefshme për të fituar të drejtën e pronës në paluajtshmeritë kontestuese, por përkundrazi mbi bazën e fakteve të vërtetuara me provat e administruara është vërtetuar se paluajtshmeria lëndore është e evidentuar në prone shoqërore.”
60. Gjykata sjell sërish në vëmendje se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës në pronë duke theksuar se ata janë pronarë të paluajtshmerisë së kontestuar dhe se kjo e fundit gabimisht është regjistruar si pronë shoqërore.
61. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet edhe në praktikën e GJEDNJ-së (shih *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 nëntorit 1983 dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).
62. Parashtruesit e kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për aq sa vendimet e kontestuarra kanë të bëjnë me “pronën” e tyre. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të jetë “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë “prishmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI26/18, parashtruesi i kërkesës “*Jugokoka*” Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49 ; KI156/18, parashtrues i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52 dhe rastin KI41/19, me parashtrues *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15 janarit 2020, paragrafi 60).
63. Në dritën e fakteve të mësipërme, pavarësisht se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ngritur shprehimisht pretendime që lidhen me gjykimin e drejtë (të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës), Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesve të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i procedurës

bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ata kanë mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsideronin të rëndësishme për rastin e tyre; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tyre janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shqyrtuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta.

64. Prandaj bazuar si më lart, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur se si vendimi për refuzimin e kërkesëpadisë së tyre nga Gjykata Themelore, e vërtetuar edhe nga Gjykata e Apeli dhe ajo Supreme kanë shkelur të drejtën e tyre në pronë, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të tyre pronësore, të garantuara me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani